

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	08.11	2021	
Nj. Org	më	Vlera	
01-400-57569			



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit	Nr. Prof. Br. Prof. 1275
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	Datum: Date: 17.05.2021
PRISHTINË/A NO.1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Në bazë Ligjit Nr. 03/L-189 mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82, 21 tetor 2010) dhe Nenin 13 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, lidhet kjo;

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Në mes të

MINISTRIA E EKONOMISË
dhe

Komunës së Drenasit

Për transferin e pasurisë jo-financiare;

Ministria e Ekonomisë (në tekstin e mëtejme ME) dhe Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejme: Përfituesi), janë pajtuar për transferin e pasurisë jofinanciare: **Lloti VII "Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme -Programi mbështetës-Zbatimi i masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike (VII)"**

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Projekti: “Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje tjera të obligueshme - Programi mbështetës-Zbatimi i masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike (VII)”- me numër indentifikues 213/019/027/521, i implementuar në vitin 2020 në shkollën “Dëshmoret e Fortesës”, në Vërboc – Drenas.

1.1. Vlera e financimit në këtë shkollë është, 33,434.12 Euro.

Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Përfituesi merr në pronësi pasurinë jo-financiare nga Neni 1 i kësaj Marrëveshje.
2. ME, me qëllim të zbatimit të rekomandimit nga auditimet e energjisë, dizajni dhe specifikacioni teknik ka zbatuar masat për eficiencën e energjisë, duke financuar dhe perfunduar projektin nga neni 1, e financuar dhe cilesuar si Pasuri kapitale e Qeverise se Repubikes se Kosoves.
3. ME, ruan te drejten e shfrytezimin e te dhenave nga zbatimi i rekomandimeve te projektit nga Neni 1, (në tekstin e mëtejme: Objekti i Marrëveshjes)

Neni 3

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit

1. Përfituesi merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimesh pasurinë jo-financiare nga Objekti i Marrëveshjes (Secila pjesën e vet nga Neni 1, pika 2 e marrëveshjes).
2. Përfituesi mirembane dhe barte te gjitha obligimet tjera qe mund te dalin per funksionimin e rregullt te projektit nga objekti i marreveshjes, si ndriçimi dhe pajisje tjera te instaluar ne kuader te projektit.
3. Përfituesi (pjesë shtesë te ketij dokumenti) do ta ketë në pronësi të gjithë dokumentacionin që bën të formalizuar projektin nga Objekti i Marrëveshjes;

3.1. Kontratat;

3.2. Faturat e projektit;

3.3. Projekti i zbatimit.

3.4 Procesverbali i pranimi të situacioneve sipas implementimit të projektit në objekte.

3.5 Urdhër-pagesa.

Neni 4

Gjendja teknike e projektit

ME i derzon përfituesit projektin nga Neni 1 pika 2 e kesaj marreveshje, ne gjendje te rregullt tenike dhe sipas standardeve te paraqituara ne projektin detal dhe specifikacioni teknik. Të gjitha keto jane te vertetuara nga Menaxheri per mbikqyrjen e kontratës dhe Komisioni për pranimin teknik të punëve.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bëjnë përpjekjen për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Në rast të ndonjë mospajtimi, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes, duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Prishtinë

Neni 6

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Në emër të:

Në emër të:

Ministritë së Ekonomisë



Fatos Oerimi, Sekretar i Përgjithshëm




Prishtinë;

Data e nënshkrimit; 17/5/2021



Komuna/ Drenas.



Ramiz Lladrovci - Kryetar

08/11/2021

